



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 89/2017

Prishtinë, më 7.3.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë, si dhe deputetët Fatmir Xhelili dhe Donika Kadaj - Bujupi.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë dhe Rustem Berisha, antarë.

E ftuar: Edita Tahiri, ministre për Dialog.

Pjesëmarrës të tjerë: Mustafë Hasani – KOSTT; Elona Cecelia – MD; Arjeta Emra, Arjeta Galimuna, Eda Spahiu, Dani Josifofski, Marina Nesiç, Slaxhana Paloviç, Danjela Bugorin - British Council; Kushtrim Ahmeti – KTV; Pranvera Musa – KosovaPress; Fitore Ademi - RTV21; Vlora Nushi – UNMIK/OPA, Amir Kozmaqi – INDEP; Jeton Krasniqi – KDI; Etleva Malushaj – LVV; Agron Avdyli, Sami Salihu dhe Arianit Berisha – studentë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.2.2017;
3. Ecuria e anëtarësimit të KOSTT-it ne ENTSO-E (e ftuar ministrja për Dialog, znj. Edita Tahiri);
4. Themelimi i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që të fillohet më shqyrtimin e pikës 4 (katërt) të rendit të ditës “Themelimin i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore” si pikë e tretë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetari.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.02.2017

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 28.02.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Themelimi i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore

Kryetari tha se Ligji për Dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore në Planin e punës së Komisionit për vitin 2017, e kemi paraparë që të bëhet mbikëqyrja e zbatimit të tij, marr parasysh rëndësinë e tij.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V E N D I M

1. *Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Ligjit për Dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Raif Qela kryesues, Besim Beqaj, Blerim Grainca, si dhe dy anëtarë të opozitës;*
3. *Grupi punues në bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Ecuria e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E

Kryetari: Ne kemi vendosur që ta trajtojmë këtë çështje, pra problemin e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, si një çështje shumë më rëndësi dhe vitale. Kjo çështje është aktualizuar kur e kemi përkrahur marrëveshjen e partneritetit me Shqipërinë në fushën energjetikë. Prandaj, sot për këtë çështje e kemi ftuar ministren për Dialog znj. Edita Tahiri, bashkë me drejtorin e KOSTT-it z. Mustafë Hasanin, që të na informojnë se ku janë problemet rreth pozitës së KOSTT-it edhe anëtarësimit në ENTSO-E.

Edita Tahiri, ministre për Dialog: Marrëveshja e Brukselit për energjinë është arritur më 8 shtator 2013 në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Ndërsa Plani për zbatim të marrëveshjes është arritur më 18 shtator 2014. Marrëveshja ka përcaktuar që Kosova, respektivisht operatori i sistemit të transmissiionit të energjisë të Kosovës –KOSTT të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të bëhet anëtar i ENTSO-E, Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të

Transmisionit. Si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit, Kosova është pavarësuar ndërkombëtarisht në fushën e transmisionit të energjisë, më 1 tetor 2015, kur KOSTT ka nënshkruar marrëveshjen për kyçje me ENTSO-E. KOSTT është gati për të filluar funksionimin e tij si OST e pavarur. Mirëpo, KOSTT ende praktikisht nuk mund të fillojë veprimin si transmetues i pavarur i energjisë së Kosovës. Kjo për shkak se Serbia refuzon të zbatojë Marrëveshjen e Brukselit, pavarësisht se ka nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare në Bruksel dhe pavarësisht zotimeve se të dyja shtetet kanë konfirmuar angazhimin e tyre për të përmbushur të gjitha detyrimet e tyre në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe për të aplikuar *acquis* e energjisë të BE-së. Marrëveshja e Brukselit për energjinë në nenin 2 parashikon që KOSTT dhe EMS të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe brenda 3 muajve, për vendosjen dhe rregullimin e marrëdhënieve mes dy Operatorëve të Sistemit të Transmisionit. KOSTT do të njihet si Operator i Sistemit të Transmisionit për territorin e Kosovës me qëllim të pjesëmarrjes në të gjithë mekanizmat relevantë, ITC, Menaxhimi i ngjeshur, etj. EMS do të mbështesë KOSTT-in që të bëhet një anëtar i ENTSO-E. Marrëveshja për Energji ka qenë në tryezë për negociimin në Bruksel për rreth gjashtë vjet. U deshën më shumë se tre vjet për të arritur marrëveshjen dhe një tjetër vit për të rënë dakord me planin e veprimit. Marrëveshja shtesë për këtë çështje, u arrit më 25 gusht 2015 në nivelin më të lartë politik në mes të dy shteteve nën lehtësimin e BE-së. Ajo ka përcaktuar detajet e fundit të detyrimeve të zbatimit për të dyja palët, por nuk ka ende asnjë përparim në zbatimin e marrëveshjes të Energjisë. Edhe pas gjashtë viteve të negociatave, Serbia vazhdon të jetë pengesë në këtë çështje, duke paraqitur pengesa të vazhdueshme dhe të pabazuara. Pengesat e fundit kanë të bëjnë me regjistrimin e një kompanie të re për furnizim të energjisë në Kosovë, në bazë të ligjeve të Kosovës. Kjo parashikohet nga marrëveshja e Energjisë, e cila në nenin 4 përcakton se një kompani e re do të regjistrohet dhe të veprojë në përputhje me ligjin e Kosovës dhe kornizën rregullative të Kosovës. Kjo kompani e re nuk është regjistruar ende sepse nuk ka respektuar ligjet e Kosovës gjatë aplikimit për regjistrin. Rëndësia e zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit për energji është e shumanshme, për Kosovën dhe rajonin. Kjo do të ndihmojë në konsolidimin e sistemit të Kosovës të transmetimit të energjisë dhe stabilitetit energjetik, stabilitetit rajonal të energjisë dhe të sigurisë, fillimin e interkoneksionit të energjisë Kosovë-Shqipëri, e konsolidimit të infrastrukturës energjetike në rajon dhe Evropë. Qeveria e Kosovës ka qenë vazhdimisht duke i bërë thirrje BE-së, SHBA dhe Gjermanisë për të ndihmuar në zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë, duke kërkuar nga Serbia për të afruar nga ajo që ka pranuar dhe nënshkruar. Çështja u ngrit në Samitin e Ballkanit Perëndimor të gjashtë vendeve në Paris 2016, në konferencat ministrore të Evropës Juglindore. Samiti i Parisit, mbajtur më 5 korrik 2016, për zbatimin e WB6 ka përfunduar si vijon: Çdo OST duhet të lejojë transmetimin e energjisë elektrike, Sistemin dhe Operatorin e Tregut në Kosovë (KOSTT) të jetë i lidhur me Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-e) dhe alokimin e kapaciteteve në linjat e interkonjeksionit të saj me vendet fqinje, në përputhje me Marrëveshjen e Kyçjes nënshkruar me ENTSO-e. Në mbështetje të gjetjes së zgjidhjes, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë në mbledhjen, e mbajtur më 14 tetor 2016, pas një ankese nga KOSTT kundër Serbisë në rastin ECS-3/2008 u konfirmua se Serbia ka shkelur Traktatin për Themelimin e Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore, respektivisht neni 6 i rregullores EC 1228/2003 në lidhje me Kosovën. Ata kanë caktuar 31 dhjetorin 2016 si afatin e fundit për Serbinë për të zgjidhur këtë çështje. Takimi i Nivelit të Lartë i ENTSO-E dhe SEE OST më 2-3 nëntor 2016 në Selanik arriti në përfundimin se moszbatimi i KOSTT--ENSTO E marrëveshjes për kyçje paraqet çështje bllokuese për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike dhe integrimin në rajon. ENTSO-E në përpjekjet e saj për të ndihmuar për tejkalimin e kësaj çështjeje u mblodh në një

takim, më 25 nëntor 2016, duke ftuar edhe KOSTT dhe EMS, me qëllim të gjetjes së mundësisë për të vënë në funksionim marrëveshjen 2015, e lidhjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E. Megjithatë, asnjë rezultat nuk doli prej tij, duke pasur parasysh se Serbia e refuzoi propozimin e zgjidhjes nga ENTSO-E. Si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit për energji, Kosova është pavarësuar ndërkombëtarisht në fushën e transmisionit të energjisë. Kjo ka ndodhur, në tetor 2015, kur Kosova përkatësisht KOSTT-i ka nënshkruar marrëveshjen për operim të pavarur shtetëror në fushën e transmisionit të energjisë me organizatën evropiane të sistemeve transmetuese të shteteve (ENTSO-E). Pra, ligjërisht Kosova ka marrë njohjen ndërkombëtare si shtet i pavarur në fushën e transmisionit të energjisë. Por, fillimi i punës në praktikë është bllokuar nga Serbia tash e dy vjet, gjë e cila ka ndikuar edhe në mos nisjen e funksionimit të interkonjeksionit Kosovë-Shqipëri. Bashkimi Evropian ka ndërmarrë disa masa detyruese ndaj Serbisë duke e kushtëzuar Serbinë me kapitullin 35, me të cilën Serbia detyrohet të zbatojë gjitha marrëveshjet, përfshirë dhe marrëveshjen e energjisë nëse dëshiron të bëjë përparime në rrugën e integritetit evropian. Praktikisht, stabiliteti energjetik dhe siguri në rajon është vendosur në shpatullat e Kosovës në kurriz të Kosovës. Më 6 gusht 2008, Kosova përkatësisht KOSTT ka paraqitur kontestin para Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe është vendosur pozitivisht për Kosovën. Megjithatë, BE-ja nuk ka lejuar zbatimin e vendimit nën arsyetimin se ajo do të zgjidhet nëpërmjet dialogut në Bruksel. Tani gjashtë vjet më pas, duket se agonia u zgjat dhe, Serbia amnistohet për shkelje të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Kosova ka vazhduar të luajë një rol të stabilitetit, edhe pse ajo mund të përdorë masa të njëanshme kundër shkeljeve të Serbisë. Në kontekstin rajonal, dështimi i Serbisë për zbatimin e marrëveshjes ndikon negativisht në bashkëpunimin rajonal mbi sigurinë e energjisë dhe stabilitetin. Ajo ka bllokuar gjithashtu fillimin e linjës interkonektive 400 KË në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, për shkak të faktit se KOSTT është bllokuar për të operuar në mënyrë të pavarur, edhe pse me ligj është një OST e pavarur duke pasur parasysh marrëveshjen e nënshkruar me ENTSO-E. Qasja në veri të vendit pezull, për shkak të moszbatimit të marrëveshjes së energjisë, KOSTT dhe KEDS si distributor i vetëm publik, ende nuk kanë qasje në pjesën veriore të Kosovës. Gjithashtu, shërbimet e shpërndarjes nuk mund ende të ofrohen për konsumatorët në veri, sepse KEDS nuk mund të nënshkruan kontratë me kompaninë e re të furnizimit e cila mbetet e paregjistruar dhe palicencuar e bllokuar nga Serbia. Përveç kësaj, konsumi i energjisë nga qytetarët në veri vazhdon të jetë i papaguar, i cili krijon humbje në KEDS dhe KESCO, të cilat janë duke u kompensuar duke i ngarkuar qytetarët e pjesëve të tjera të vendit. Janë dy marrëveshje që synojnë vendosjen dhe rregullimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmisionit të dy shteteve.

Kryetari, për z. Mustafë Hasani, pyetje, së cilat janë dëmet që nuk e keni statusin në ENTSO-E? Dhe dëmet e mosfunksionalizimit të largpërquesit të interkonksionit më Shqipërinë?

Mustafë Hasani, drejtor i KOSTT-it, KOSTT-i ka qenë i angazhuar sidomos 3 muajt e fundit sa i përket çështjes së zhbllokimit të kësaj bllokade të marrëveshjes me ENTSO-in. Ne jemi dëshimtarë se vërtet kjo bllokadë ka pasur ndikimin jo vetëm financiar, por edhe të integriteteve rajonale, të hapjes së tregut, bashkëpunimeve të tjera që janë në alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e koncesionit në vënjen e linjës në funksion Kosovë-Shqipëri dhe në arritjen e ca elementeve që janë teknike të cilat përmisojnë operimin e operatorit të sistemit të transmisionit KOSTT në kontekstin funksional i pavarur. Alokimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i koncesioneve atë që ministria për dialog e tha në një shprehje jashtëzakonisht praktike se është

një ngulfatje ajo që KOSTT-i ka për detyrë me i aloku kapacitetet. Në një metodologji të llogaritjes që ne kemi pasur në vitin 2014 – 2015 konsiderojmë se dikund një e hyrë prej 3 deri në 5 milionë euro brenda vitit është dëmi financiar i cili i shkaktohet KOSTT-it. Elementi që konsideroj që është pozitiv për të cilin nuk u përmend është se në janar të viti 2016 për herë të parë në përputhje me këtë marrëveshje që s'po funksionalizohet tërësisht. Ne kemi filluar me i inkasuar të hyrat për tranzitë prej vitit 2016 për të gjitha shtetet të cilat e kalojnë energjinë elektrike nëpërmjet Kosovës. Ku në bazë të analizave të fundit konsideroj që dikund janë 300-400 mijë euro të hyra të cilat janë realizuar për vitin 2016 të cilat do të realizohen edhe gjatë viteve tjera. Po konstatojmë se edhe linja interkonektive Kosovë-Shqipëri mund ta ketë një vend financiar, e atëherë ka dëme në operime të përbashkët të shëmbimit të rezervave në kohën kur ka nevojë Shqipëria dhe në kohën kur ne kemi nevojë, por njëkohësisht ne kemi edhe një projekt tjetër që është brenda kësaj linje që mundëson mirëmbajtjen e rezervave në formë automatike e cila mund të angazhohet në momentet kur është e nevojshme. Vlera e implikimit financiar mund të jetë dikund ndoshta deri në vlerën 1 milion euro edhe krejt këto ndikime ne i kemi adresuar tek institucionet që më përgjegjëse për çështjet energjetike. Konsideroj se këta kanë pas efektin pozitiv të cilin ne, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë edhe Këshilli i Ministrave kanë vendosur me vota unanime se kjo është shkelje e marrëveshjes së Traktatit të Energjisë prej Serbisë edhe është kërkuar që e njëjta ta zhbllokojë KOSTT-in. Bllokada ka ndodhur brenda kësaj marrëveshje, ku ka qenë një kusht, që ne zakonisht e quajmë kusht politikë në të cilin është kërkuar që Serbia të regjistrojë një kompani në pjesën veriore të Mitrovicës.

Edita Tahiri, ministre për Dialog, kërkoi veç një plotësim, jo në pjesën Veriore, por në Republikën e Kosovës, sepse s'ka ndarje kompania. Kompania regjistrohet në agjenvion edhe nuk përcaktohet ku.

Mustafë Hasani, drejtor i KOSTT-it: Serbia asnjëherë nuk ka pas interesim për çështje teknike, 3 elemente kanë qenë të rëndësishme të cilat është dashur me i dokumentuar para të gjithë këtyre antarëve që i përmendëm, për shkak se kompania nuk po regjistrohet prej anës së Kosovës, në qoftë se KOSTT-i bëhet i pavarur ka me pas probleme me furnizimin e e energjisë elektrike për këtë pjesë dhe në fakt kjo ka qenë angazhimi jonë me e demantuar. Kemi dhanë edhe shembuj që e kanë dokumentuar dhe e kanë provuar që nuk ka asnjë problem për furnizim të energjisë elektrike për pjesën të cilën ata mbajn shqetësimin. Një përkrahje ka qenë letra që është dërguar nga Komisioni Evropian që më përkrahe të Marrëveshjes ENTSO-E, po ashtu një përkrahje është edhe nga Sekretariati i Energjisë që mbështet KOSTT-in dhe konsideron se janë hargjuar të gjitha mekanizmat dhe është e nevojshme që kjo asamble më votuar një marrëveshje që është e re. Më marrëveshjen e re ekzistojnë thjeshtësime për shkak që kërkohet një mbështetës i kësaj kërkesë në momentin e kësaj marrëveshje. KOSTT-i mundet me filluar me vepruar në formën e pavarur. Ne jemi të angazhuar në kontekstin teknik, e kemi pas një parapërgaditje kryesisht për çështje tona më ministren për Dialog dhe bashkërenditje më ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe faktorë të tjerë.

Kryetari: Qëllimi i kësaj mbledhje është që këto pengesa të tejkalohen, por që edhe Kosova prej që është një vend i pavarur ka agjendë dhe iniciativa të cilat i kontribuojnë stabilitetit dhe paqës në rajon dhe ky diskutim është i orientuar pikërisht në atë drejtim, por njëkohësisht për t'i evituar pengesat për zhvillimin e sistemit energjetik në përgjithësi. Natyrisht që Kosova gjithmonë është e durueshme është e kuptueshme që të jetë e durueshme në negociata, mirëpo në qoftë se vije në

një situatë ku nuk ecin punët edhe Kosova duhet t'i përdorë ato instrumente që i ka në duar, parimet që t'i evitojë dëmet të cilat i shkaktohen në ekonomi dhe sistemin energjetikë, duhet t'i proklamojmë këto dëme dhe t'ia caktojmë një afat dhe përgjegjësinë nuk e ka Kosova pse nuk po i zbatonë, por përgjegjësinë e ka ai i cili nuk e zbaton marrëveshjen.

Besim Beqaj: Ajo çka dëgjuam këtu dhe në bazë të informacionit të cilin e kemi marrë me shkrim nga Ministria për Dialog, shihet një përshkrim i gjendjes i cili tregon hapat institucional të cilët janë marrë deri më tani. Çështja është se si të trajtohen dhe si të shtyhet zbatimi i marrëveshjes duke i hequr disa dilema në kokat tona që Sekretariati i Energjisë mund t'i zgjedhë, duhet ta bëjë me dije se Sekretariati i Energjisë është trup koordinues i anëtarëve të Traktatit dhe nuk është autoritet. Sekretariati i Energjisë ekskluzivisht e ka për detyrim me punuar për vendet anëtare dhe në ankesën që është bërë në Traktat, pra një opinion i cili nuk ka konotacione ligjore dhe duhet të kuptohemi. Në atë kohë kam qenë ministër dhe e kam udhëhequr atë proces vetë, veç është dashur të kalojë në Këshillin e Ministrave, por edhe Këshilli i Ministrave prapë nuk është autoritet, pra duhet të kuptohemi. Këshilli i Ministrave nuk është autoritet detyrues për Serbinë për ta bërë një veprim të tillë. Pra, nuk konsideroj që kemi kryer punën sepse kemi shkuar deri në Sekretariat jemi ankuar ose kemi shkuar deri në Këshillin e Ministrave dhe jemi ankuar. Këtë vit e kemi kryesimin e Këshilit të Ministrave dhe besoj që ka me pasur një lloj dinamike pak më të madhe, po që realisht duhet ta qartësojmë me vetën një proces të tillë. Një gjë e cila ka ndodhur dhe besoj që duhet ta përdorim si levë është investime me largpërques me Shqipërinë. Ne e kemi bërë një marrëveshje me Shqipërinë e cila do të duhej të jetë qendër e përbashkët për këmbimet energjetike dhe si e tillë ne duhet të levizim dhe duhet me e pasë shteti i Kosovës është me energjin gjenerale që është autoritet në nivel të Bashkimit Evropian e cila merr veprime te tilla. Jam takuar dy herë me komisionerin për energjinë ku kemi biseduar për formatin e anëtarimit të KOSTT-it në ENTSO-E, dhe duhet ta kuptojmë që anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E është me kusht, nuk është anëtarësim i plotë. Kushti është që të bëhet regjistrimi i ndërmarrjes e cila, unë konsiderojë personalisht ku e kam thënë edhe më herët edhe prapë po e them, besoj që ka qenë gabim në marrëveshje, duke e marrë parasysh se iniciativat fillestare kanë qenë që duhet të bëhet një kompani në Veri e cila do të jetë nënkotraktore e KEK-ut për të grumbullu paratë në Veri, pra kështu ka qenë fillimi i të gjitha negociatave dhe i zhvillimeve të cilat në ndërkohë janë bërë. Unë besoj që në marrëveshjen teknike që dinamika është e shpejtë dhe kur gjërat bëhen shpejt për Kosovën bëhen keq, po e themë shumë hapur pa asnjë lloj hezitimi. Unë kisha hezituuar shumë që neve të hyjmë në marrëveshje teknike, sido që të jetë ju jeni persona përgjegjës të cilët i dini këto çështje në nivel të shtetit, mirëpo duhet të kemi shumë kujdes sepse marrëveshjet teknike na janë afruar edhe më herët, bile- bile marrëveshje teknike kanë bërë edhe në infrastrukturë të përbashkët. Ka masa dhe, ne i kemi marrë disa prej tyre më herët dhe ato janë tri, pasi që i kemi marrë edhe më herët dhe besoj që mund të merren. Një është limitimi i furnizimit me energjinë elektrike si format presioni, hynë në mospërmbushjen e këtyre marrëveshjeve, ne i kemi vendos ata në nivele teknike mund të shkojnë deri në 6 MGË, por njëkosisht kjo na implikon edhe rregullën me bashkpunimin me Vallaqin. Vallaqi është një stacion në Veri, i cili është jashtë kontrollit tonë dhe i cili e bën shpërndarjen e energjisë elektrike në Veri, e cila furnizohet nga Novi Pazari. Pra, janë dy furnizime të energjisë elektrike, njëra rrjedh nga Novi Pazari dhe pjesa tjetër prej Pejës, energjia shkon në Veri. Dhe është një kombinim tjetër ku besoj që teknikët duhet ta dinë është furnizimi nga Trepça, sepse është një qendër ku mund të merren masa. Pra, limiti është një nga format e cila është në dorën tonë dhe mund bëjmë dhe si të tillë do e mundëson që ne t'i bëjmë presion shumë më shumë Vallaqit, e di që nuk është fort veprim i mirëpritur edhe nga miqët

ndërkombëtarë, por duhet të trajtohet që edhe Vallaqi të merret në kontroll. Veprimi tjetër i cili besoj se do të duhej të merrej, është të tërhiqet energji nga rrjeti. Ne nuk mundemi me e depozituar energjinë, por këto veprime i kemi bërë në të kaluarën, KOSTT-i dhe KEK-u dhe KEDS-i në baza ditore ose javore dërgojnë raporte në Bruksel, ku kjo është ndërtuar në kohën kur unë kam qenë ministër, për të gjitha humbjet dhe vjedhjet që shkaktohen në rrjet nga Serbia në mënyrë që ne ta kem si levë bazohet në baza javore, gjithmonë ku neve kur të vije momenti i ballafaqimit të borxheve të njëanëshme apo të dyanëshme dhe mund të tërhiqet energji në mënyrë të pa autorizuar nga rrjeti do të thotë energjinë të cilën Serbia e transporton tranzit nëpër rrjetin e KOSTT-it mund një pjesë e saj të ndalet dhe normalisht t'i shkojë distributorit dhe t'ju shkojë edhe qytetarëve dhe kjo çështje bëhet momentalisht në formë të pakompenzuar, por që ka me u regjistruar si borxh që do ta kemi ne raport me Serbinë në të ardhmën dhe besoj që është një veprim krejtësisht konkret dhe jo krejt i mirëpritur, por që neve duhet t'i kemi masat tona me të cilat neve do të kemi aftësi që ta shtyjme edhe Serbinë edhe Bashkimin Evropian edhe Traktatin edhe Sekretariatit që atë marrëveshje ose duhet ta respektojmë ose duhet të vendosim për rrugë të tjera këto. Që ne duhet të marrim hapa ose duhet ta bëjmë plotësisht anëtare ose duhet me gjetur rrugë tjetër.

Fatmir Rexhepi: E dëgjuam informatën e Ministrës të cilët janë munduar me punuar aq sa kanë mundur të punojnë në këtë fushë, por ato që u raportuan këtu po qe se e lexojmë në mënyrë korrekte tregon se një marrëveshje e cila nuk mund të zbatohet, një marrëveshje e cila dështon nuk është marrëveshje e mirë. Këto pikat ku shkruan në këtë raport rezultojnë që gjithkund ka dështuar për gjashtë vjet për sa ekziston kjo marrëveshje dhe shtrohet pyetje atëherë çfarë do të kishte me qenë një marrëveshje tjetër e cila do të kishte mund që të realizohet apo zbatohet në Kosovë? Si qytetar i Kosovës nuk shpresoj nuk po hyj në atë për punën, mundin dhe të gjitha ato që është munduar Ministria, ajo është tjetër temë, por kjo është pjesë e medaljes tjetër dhe kur flasim për rezultatin konkret të një marrëveshje mendoj që interferimet të cilat ju kanë lejuar Serbisë brenda marrëveshjes në të gjitha fushat kanë bërë që të jenë pengesa kryesore. Dhe tani shtrohet pyetja se a është dashtë që gjithë gjatë kësaj kohe, pra që të ndodhë që brenda një dialogu për të cilën është proklamuar krejtësisht ndryshe dhe për të cilin Bashkësia Evropiane po ashtu ka qenë lehtësues dhe pjesëmarrës e cila e ka njohur Kosovën si shtet i pavarur dhe e cila po ashtu ka bërë gabime të mëdha në raport me këtë pavarësi të Kosovës? Sepse nuk mundemi neve me e quajtur një marrëveshje e cila po na jep neve një pavarësi në fushën e energjisë e cila nuk mund të zbatohet, nuk ekziston kjo pavarësi as teknikisht dhe as politikisht. Andaj, çdo marrëveshje - edhe pse u tha këtu në fillim që mos ta politizojmë - në këto relacione është marrëveshje që brenda saj ka çështje politike, kushtetuese, ligjore, ekonomike dhe shumë gjëra të tjera, pra është një kompleks jo i lehtë për t'u zgjedh. Mendoj, që dialogu edhe përpjekja për një marrëveshje me lëshimet të cilat janë bërë që Serbia të interferohet të futet më ndërmarrjet e veta të cilat i menaxhon shteti i Serbisë brenda Kosovës, ka qenë gabimi më i madh. A mund të korrigjohet mënyra e këtij dialogu? Unë këtë nuk e di dhe a mund të ketë suksese ndonjëherë! Unë mund të them që jo, as për ato tema të cilat i kemi në Kuvend, as për ato që kemi biseduar për çështje të tjera. Unë mendoj që nuk ka me pasur mundësi, prandaj po dua me e tërheq vërejtjen edhe atë që çdo herë kur prezantohet diçka, duhet të prezantohet në mënyrë sa më korrekte në mënyrë sa më të drejtë dhe të mos themi se jemi në pavarësi të plotë edhe e shtrijë integritetin kushtetues brenda në Kosovë edhe në fushën e ekonomisë sepse nuk e kemi, sepse po e cenojmë më këtë marrëveshje, sepse barikadat, bllokadat i ke nga të gjithë, bllokad përherë ju ka leju dhe ju ka mundësuar për një shtet tjetër. Prandaj, unë këtë sugjerim e pata dhe nuk pajtohem me shpjegime

të cilat po teprohen në këtë sepse nuk janë në dobi dhe në interes për vendin, se a ka mundësi të korrigjohen le t'ia lëmi kohës.

Donika Kada- Bujupi, faliminderit në rend të parë për mundësin që na dhatë sot që të jemi këtu, sepse s'jam anëtare e këtij Komisioni, ku do të diskutojmë lidhur me këtë çështje të rëndësishme të vendit tonë, për shkak se ka shumë kohë që marrveshjet të cilat vijnë nga Brukseli në fakt provohen të shihen brenda vendit si suksese të arritura me rezultate të mëdha, por që ndërkohë nuk shihet që gjendja në terren ka ndonjë përmirësim, përkundrazi po duket që ata të cilët fitojnë nga këto marrëveshje në vazhdimësi janë pala tjetër në këtë rast Serbia. Ndërkaq, Kosova po e paguan koston ashtu siç tha edhe vetë ministrja, ku disa i po e mbajmë në supe gjithë këtë qasje destruktive e cila në vazhdimësi po vjen nga Serbia. Kam dy, tri pyetje sepse kam pak paqartësi me qëndrimet e ministrës. Më 1 tetor të vitit 2015, ministrja ka deklaruar se kemi arritur një rezultat të madh, do të thotë jemi anëtarësuar në rrjetin evropian dhe ky rrjet na njeh pavarësinë energjetike të Kosovës dhe të KOSTT-it, ndërkohë që në të njëjtën ditë në faqën e vet zyrtare, në fakt kjo u demantua nga rrjeti evropian për shkak se ata në komunikatën e vet në fakt theksojnë se kjo marrëveshje është një shprehje e mbështetjes së shteteve nënshkruese bilaterale, mirëpo do të thotë në fund të informatës shkruan qartazi se nënshkrimi i marrëveshjeve të tilla nuk e bënë KOSTT-in anëtarë të ENTSO-E. Po ashtu, është fusnota, pra ky është qëndrimi zyrtar i rrjetit evropian e ndërkohë që dje, si anëtare e Komisionit për Integritet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, po ashtu kemi pranuar një dokument i cili në fakt vërteton këtë gjë duke e mohuar dhe duke e demantuar qëndrimin e ministres. Tashi nëse njëherë ne jemi pranuar, pse Qeveria po kërkon që të pranohemi përsëri, dhe pse dy – tri orë pas deklaratës dhe madje qëndrimit zyrtar në web faqen e KOSTT-it që ne tani jemi anëtarë i cili i kemi të drejtat e plota dhe na njihet pavarësia dhe ndodh e kundërta në rrjetin evropian. Në fund të fundit ne nuk kemi nevojë që ta rrejmë vetvehtën dhe asnjëri tjetrin sepse pastaj janë më shumë pothuajse dy vjet që ne nuk po e gëzojmë këtë të drejtë, jemi të bllokur dhe nuk jemi aspak të pavarur, përkundrazi ne nuk po mundemi ta zbatojmë as marrëveshjen me Shqipërinë për shkak të marrëveshjes së datës 25 gushtit sepse Serbia po e bllokun. Mandej edhe interkoneksioni që është një mundësi shumë e mirë e jashtëzakonshme që ne të kemi një balanc të hidros dhe termos nuk po mund të realizohen. Pastaj në vitin 2013, po e lexoj një deklaratë të ministrës ku thuhet: se pas marrëveshjes për energjinë KOSTT, si autoritet i transmisionit të energjisë, më nuk do të jetë i penguar që të anëtarësohet në organizatat evropiane dhe rajonale, si dhe Serbia tash e tutje nuk mund të shfrytëzojë rrugët e transmisionit të shtetit të Kosovës pa i kompensuar për shfrytëzim kështu që në vitin 2013 e keni thënë këtë zyrtarisht para 5 minutave thatë që Serbia po e shfrytëzon rrjetin, por nuk po paguan dhe neve po e bartin barren mbi supet tona. Do të thotë janë dy deklaratatë të cilat janë në kundërshtim krejtësisht me njëra- tjetrën. Në vitin 2011, unë isha anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme, në pyetjen time se kemi informata që një kompani e cila do të menaxhohet nga Serbia, të pranohet nga pala kosovare dhe do të lejohet regjistrimi i saj dhe asaj do t'i jepet licenca. Ministrja aso kohe, sa isha në atë Komision, e ka mohuar këtë dhe ka qenë mjaft këmbëngulëse madje më kujtohet që keni thënë që po bijmë pre e propagandës së Serbisë, sepse kjo asnjëherë nuk do të ndodhë. Fillimisht keni thënë që lejimi i funksionimit të kompanisë serbe në fakt nuk do t'i ketë në dispozicion asetet të cilat i takojnë rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, por në marrëveshjen politike të vitit 2015 vëhet qartë se kompanisë së Serbisë i barten këto kompetenca, konkretisht Serbia do të ketë kontrollin mbi resurset e shpërndarjes të energjisë elektrike në Kosovë, tashi cila është e vërteta? Në qoftë se aq shumë e keni kundërshtuar në vitin 2011 para Komisionit për Punë të Jashtme aso kohe dhe nëse ndërkohë e keni pranuar dhe

keni deklaruar se nuk do të ketë qasje dhe nuk do të ketë pronësi mbi asetet tona atje tani keni lëshuar pe edhe më tutje edhe po provoni që të njëjtën ta aprovoni si sukses. Janë deklarata shumë kundërthënëse të cilat bien ndesh me njëra tjetrën të cilat në vazhdimsi po na prodhojnë marrveshje të dëmshme. E ftoj drejtorin e KOSTT-it, e kisha ftuar që të tregojë rreth shifrave të shumave të cilat neve po i humbim si shtet sepse këtë pjesën politike e laborojë ministrja. Sepse disi po krijohet përshtypja që zonja ministre që po të ishit këmbëngulëse kundruall Serbisë në të vërtetat dhe të drejtat tona si Kosovë, aq sa jeni këmbëngulëse kondruall deputetëve në Paralement e para qytetarëve të Kosovës që t'i paraqitni bisedimet dhe dialogun si sukses, mendoj që edhe këto marrveshje do të ishin më të mira dhe do të ishin më të suksesëshme për Replublikën e Kosovës.

Kryetari: Vetëm duhet t'i bëhet dallimi në mes furnizimit dhe shpërndarjes, me qenë se jemi duke biseduar para opinionit dhe në shpërndarje sa kam parë unë në marrveshjen me Serbinë, ajo nuk ka asnjë ingjirencë, të gjitha janë refuzuar dhe ka vetëm një kompani që merret me furnizim, dhe mund të them se shpërndarje nuk ka dhe nuk guxon të ketë.

Blerim Grainca: Për mua bisedat të cilat janë bërë në Bruksel se paku unë i shoh jo si një fontanë dëshirash, por si një mundësi e bazuar në kapacitetet edhe në fuqinë politike edhe fuqinë për t'i realizuar të gjitha këto të cilat i ka Kosova. Problemet të cilat u ngritën këtu unë do i kisha ndarë në dy grupe dhe në grupin e parë hyjnë problemet politike, që lidhen kryekput me atë pjesën që do të duhej ta respektojë pala serbe dhe mendoj se do të duhej të zhveshemi nga pritjet se Serbia ka vullnet për me i zbatuar marrveshjet politke. Në grupin e dytë të këtyre çështjeve, për të cilat u grindën këtu, është çështje operative dhe teknike, që lidhet me punët e shtëpisë të cilat është dashur që t'i kryejmë ne edhe si Qeveria, edhe si ne, edhe si Kosovë. Në të gjithë këtë prezantim unë po shoh një angazhim të shtuar të institucionve tona dhe të KOSTT-it për me i krye pjesën rreth obligimeve, mirëpo edhe pjesa e shqetësimit tim lidhet me krijimit e kompanisë që u ngritë këtu. Në qoftë se kjo kompani sidoqoftë si quhet operon me standardet dhe Ligjet e Republikës së Kosovës dhe është regjistruar në Zyrën e Ministrisë për regjistrimin e bizneseve për mua kjo është OK, deri sa të respektohet kushtetushmëria e vendit tonë. Një çështje që parashtrohet nga ana ime se çka tani tutje znj.ministre se a duhet që ne të presim në pafundësi që Serbia të ketë vullnet politik për ta finalizuar marrveshjen apo duhet të marrim masa qoftë nga ata të cilët e kanë organizuar këto biseda ku Bashksisë Evropiane ku në këtë rast bënë presion mbi sigurinë apo ajo që unë do e kisha rekomanduar në këtë rast dhe do e kisha sugjeruar juve të shqyrtoni mundësinë e masave të reciprocitetit, nëse jo në fushën e nergjisë për shkak se thatë ju se na shkaktohen probleme me furnizim dhe preket dhe rajoni, atëherë neve mund te kushtëzojmë zbatimin e marrëveshjes për energjinë me zbatimin e marrëveshjes në fushat e tjera.

Fatmir Xhelili: Shumica e pyetjeve të parashtruara këtu u konsumuan gjatë diskutimeve me qenë se kisha dashur me pyet lidhur me atë se a është në esencë tentimi i Serbisë në bashkëpronësi të rrjetit me operatorët, edhe a ka me qenë vetem operatori sa për me ua thjeshtësuar opinionit termin apo ka me qenë operator tregtar, apo ka me qenë operator, apo nënoperator i transmisionit d.m.th. këtu është esenca dalluese. Pyetja e dytë është, se mos mbrapa kësaj fshehen edhe frikat qysh janë duke i prezentuar Serbia, frika për mos furnizim të qytetarëve serbë në pjesën veriore që e perdorë nganjherë si pseudoargument, ku nuk besoj që ne do të përdorim atë mekanizëm si mekanizëm për me kushtëzuar. Dhe pyetja e fundit është se a jemi duke punuar në atë drejtim vetëm me gjetjen e mekanizmave të kushtëzimit apo me të vërtetë Bashkimi Evropian apo të gjitha ato

asociaciacione të cilat i përmendet nuk kanë mekanizem juridik për me vepruar në drejtim të kushtëzimit të Serbisë për me na dhënë neve mundësinë që operatori i KOSTT-it të operojë edhe juridikisht në rrjetin të cilin ne e posedojmë.

Kryetari: Mendimi im është që institucionet e Kosovës duhet të përgaditen për masa adekuate dhe duhet të zhvillojmë disa masa, qoftë si masa reciprociteti, qoftë masa të mbrojtjes të interesave ekonomike të Kosovës në mungesë të të cilave edhe në funksionimin e sistemit të transmissioinit edhe në përgjithësi në standarde dhe në cilësinë dhe sasinë e furnizimit me energji ka probleme serioze, në këtë drejtim masat duhet të jenë të tilla që të jenë stimulative që problemet të tejkalohen. E dyta në ato masa unë kisha porositur që të jemi të kujdesshëm që qytetarët tanë serbë të mos penalizohen edhe ata të fillojnë ta paguajnë energjinë këtu, më nuk ka dy lloj standardi dhe neve duhet të themi shumë qartë, ku, tash e tutje, neve kërkojmë si Komision që Qeveria dhe të gjitha subjektet të gjejnë instrumente me të cilat që secili qytetar i Kosovës do të paguajë energjinë elektrike të cilën e konsumon, qoftë ai shqiptar, serb, turk apo malazes dhe kjo çështje duhet të zgjedhet edhe në aspektin politik sepse nuk ka asnjë arsye që në baza etnike të jenë të favorizuar ata që nuk e paguajnë energjinë elektrike. Në këtë drejtim ne duhet t'i bëjmë disa pako masash, t'i diskutojmë dhe t'i jepum afat, t'i diskutojmë me bashkësinë ndërkombëtare, më pëlqeu edhe propozimi i kolegut Beqaj me DG-në t'i bisedojmë edhe me faktorët në Kosovë, por jemi të vendosur që në një afat të caktuar diku 60 ditë ato masa duhet të hyjnë në fuqi përndryshe unë nuk besoj që kështu nëse vazhdojmë në të njëjtin stil që Serbia do të tërhiqet, përndryshe ne i kemi nënshkruar ato gjëra të cilat i ka nënshkruar Kosova që kanë të bëjnë me krijimin e një kompanie që sipas ligjeve të Kosovës. Mendoj që ne më aty nuk mundemi të tërhiqemi tashi më, sepse e kemi nënshkruar dhe jemi një shtet serioz kur të nënshkruajmë, dhe, parimisht nuk ka aty të keqe në qoftë se një kompani e jashtme regjistrohet sipas ligjeve dhe kritereve tona, por ajo duhet të funksionojë si e tillë dhe sigurisht që neve e mbështetum Qeverinë e Kosovës që ta zbatojë Ligjin dhe po të kishin lejuar qysh ka dëshirë Serbia mendoj se ishte regjistruar deri tani mirëpo, institucionet tona kanë kërkuar që duhet me u zbatuar ligjet e Kosovës.

Edita Tahiri, ministre për Dialog: Për të kuptuar marrëveshjen në terësi se pari duhet ta dijmë se si ka qenë gjendja dhe pse kemi vendosur të bisedojmë me Serbinë në Bruksel. Para arritjes së marrëveshjes së Brukselit, Serbia ka ndërhyrë në Kosovë me strukturat paralele ne fushën e energjisë që ne shpesh kemi thenë në veri veprojnë operatorët energjetik ilegal të Serbisë. Pra, një arsye që ne të bisedojmë në Bruksel është që t'i shuajmë këto struktura paralele dhe të shtrijmë sistemin energjetik të Kosovës në veri. Pra, Kosova e furnizon pjesën veriore me energji dhe qytetarët në veri nuk paguajnë kompensim, këto janë dy qëllimet e mëdha të marrëveshjeve, të nxirret Serbia nga veriu. Kosova të shtrijë sovranitetin në veri dhe të bëjë kontrollin në "Vallaq". Për ta nxjerrë Serbinë dhe t'i shuajmë strukturat këmbimi ka qenë, ne lejojmë regjistrimin e një kompanie që do të bëjë vetëm furnizim pasi e lejon tregu i Kosovës dhe e njëjta kompani do të bëjë shërbime teknike si nënkontraktore e KEDS-it për të shpërnda faturat dhe mbledhur para për pagesa, pra i ka dy role. Edhe ne telekom ne kemi pasur një situatë të tillë, ne kemi marrë kodin telefonik shtetëror prej ITU-së një kompani e Serbisë degën e vet e ka regjistruar në Kosovë dhe në atë aplikacion ata e kanë shënuar në Kosovë. Vetëm këtu nuk po pranojnë dhe kur t'i binden edhe ne do t'i regjistrojmë dhe zhblllokohet marrëveshja. KOSTT-i është pavarësuar dhe Kosova ka fituar pavarësinë në fushën e transmissioinit të energjisë ndërkombëtarisht sepse ka nënshkruar marrëveshje me të gjithë operatorët e transmissioinit të energjisë të Evropës veç e veç sepse kështu

është rregulli. Kush po e pengon marrëveshjen? Serbia po e pengon, vetë e ka nënshkruar dhe vetë nuk po e zbaton dhe ajo që Donika nuk ka mundur ta kuptojë çka është thotë kjo deklarata e Ministrisë së Jashtme që thotë përkrahne pavarësinë, varet qysh e lexoni! Ja unë po ua tregoj se çka është ajo deklaratë: fakti që Serbia po e pengon marrëveshjen dhe praktikisht KOSTT nuk mundet të fillojë operimin praktik, Ministria e Jashtme po kërkon nga të gjitha këto shtete që të bëjnë presion mbi Serbinë për zbatim të marrëveshjes. Në momentin kur zbatohet marrëveshja për energjinë ta dini se ne kemi shtrirë sovranitetin në çdo cep të vendit dhe kjo është esenciale për neve. Ne të gjitha marrëveshjet që i kemi zbatuar dhe vetëm marrëveshjen për asociacionin nuk e kemi zbatuar sikundër reagim. Përndryshe këtë marrëveshje e garanton Bashkimi Evropian edhe SHBA-të dhe kjo marrëveshje do të ndodh ju thashë me ato kushte që kur procesi të vazhdojë për tri marrëveshjet se është edhe marrëveshja për drejtësinë në pritje marrëveshja për energjinë, marrëveshja për asociacionin. Masat, unë jam që t'i diskutojmë prapë një ditë bashkë pastaj e vlerësojmë strategjinë. Unë mirëpres vërtet sepse edhe vetë ua përmenda masat dhe mund të shkojmë përpara natyrisht në koordinim edhe me Qeverinë dhe partneret e rëndësishëm tanë. Fatmiri tha se marrëveshjet kur të deshtojnë nuk janë të mira, janë të këqija, unë po jap këtë përgjigje, marrëveshja është e shkëlqyeshme, mbron sovranitetin e Kosovës por pala tjetër është e keqe ajo nuk po e zbaton. Asnjë presje nuk ia ndërroj kësaj marrëveshje, sepse mbron sovranitetin, Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Kompania pra regjistrohet me ligjet e Kosovës, nuk është kompani për distribucion, lufta e Serbisë në bisedime ka qenë të fitohet e drejta për një kompani për distribucion të energjisë kjo ka qenë vijë e kuqe sepse me ligjet e Kosovës ne kemi vetëm një kompani për distribucion dhe ajo është KEDS-i. Duhet t'ua kujtoj një gjë, kur e beri UNMIK-u transferimin e kompetencave të shteti ynë, nuk na i dha edhe dështimet që UNMIK-u ishte ai që dështoj dhe lejoj që pasluftës Serbia të shtrië struktura paralele ne veri. Dialogu i Brukselit ka mundur që në shumë fusha të shuhet struktura paralele dhe të shtrihet sovraniteti i Kosovës, a kemi ende probleme të tilla, po kemi dhe kushti ynë është se nuk ka themelimit të asociacionit, që i bie pasi që të hartohet statuti në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pra nuk ka themelimit pa u shuar strukturat e mbetura paralele të Serbisë në Kosovë.

Kryetari: Sa i përket themelimit të asociacionit, nuk është që pala jonë po e kundërshton, sepse ai do të themelohet sipas vendimit të Gjykatës kushtetuese, por është pala serbe ajo që po i bojkoton institucionet dhe nuk është kooperuese në këtë drejtim.

Donika Kadaj – Bujupi: Prapë ishte një vetëdemantim sa i përket strukturave paralele sepse këtë që e tha tani po e thuani që nga viti 2011, se arsye pse kemi filluar dialogun në Bruksel dhe për të cilën nëse ju kujtohet në Parlament keni pasur një dritë të gjelbert me vija të kuqe që të mos bisedoni për çështje të brendshme të Kosovës. Ndërkohë që gjatë gjithë kësaj periudhe ju keni biseduar vetëm për çështje të brendshme të Kosovës dhe nuk jeni pozicionuar fare si palë e barabartë, por si temë. Serbia ka qenë palë, ndërsa Kosova ka qenë temë dhe kjo po shihet edhe në këtë marrëveshjen e KOSTT-it, po të mos ishte kjo logjik e mbrapsht e bisedimeve KOSTT-i dhe operatori evropian dhe nuk do të mund të pengohej asnjë marrëveshje nga Serbia, përmes kësaj marrëveshje është një “zajednicë energjetike” dhe me ju thanë të drejtën unë nuk kam besim te ju sepse shumë çka që e keni thënë deri me sot në fakt ka dalë e kundërta, prej “fjollës”, te marrëveshjet, te çështjet e KOSTT-it. Ju mund të provoni këtu të nxisni debat, unë nuk do t'ju ofendoj dhe nuk do të ju përgjigjem në mënyrën se si ju po e trajtoni këtë Komision, do të mbaj nivel. Mirëpo, këtu po ju them që nuk e keni besimin që tutje të vazhdoni bisedimet sepse të gjitha marrëveshjet të cilat ju provoni t'i shisni në opinion që janë të mira dhe të suksesshme për një

kohë shumë të shkurtër po demantohen dhe po hapin probleme të reja edhe me të thella se ato ku Kosova ka qenë në vitin 2011.

Edita Tahiri, ministre për Dialog: Singerisht së pari fort u gëzova që Donika prapë po don me mbajt nivel, për çfarë niveli po flisni znj. deputete Kadaj – Bujupi, po sjelljet tua në Parlament deri të kundërvenja ndaj forcave të policisë, për këtë lloji niveli po me flisni ju këtu? Unë çmoj nivelin kur shfaqet në çdo kohë, nivel që respekton institucionet demoktarike të vendit tonë dhe jo standarde të dyfishta, atje në sallë të Parlamentit duke e kallur e këtu kërkon nivel. Unë përgjithësisht mbaj nivelin sepse asnjëherë nuk kam manifestuar asgjë përveç sjelljeve demokratike. Tani Donika vetë ka punuar në KEK, pasi vetë ka punuar aty, po pyes a thua kurrë nuk e ka penguar që KEK-u u jepte energji komunave veriore, por me gjasë kjo Donikën nuk e ka penguar. Pra, marrëveshja është bërë për këtë qëllim që të shtrihet sovraniteti dhe qytetarët në veri të paguajnë për rrymën si çdo qytetar tjetër në Republikën e Kosovës, të hiqen strukturat paralele që pengojnë “Vallaqin” se ne kemi pasur edhe metoda tjera edhe kemi provuar, por ne kemi zgjedhur dialogun që t’i zgjidhim problemiet. Serbia në ENTSO-E nuk ka kurrfarë ndikimi ka vetëm ndikim në raport me nënshkrimin e marrëveshjes në mes të KOSTT-it dhe EMS Serbisë sepse marrëveshja, siç ju thashë në ENTSO-E bëhet shtet me shtet, por mos harroni se në ENTSO-E janë edhe pesë vendet që nuk e kanë njohur Kosovën dhe ajo “fjolla” që e përmende ti, ua ka mundësuar këto pesë vende me i thanë KOSTT-it ejani uluni këtu dhe jemi të gatshëm ta nënshkruajmë marrëveshjen për bashkëpunim dhe pavarësimin tuaj si sistem i transmetues. Pra, ky është vizioni ynë, përkushtimi ynë për ta ecur shtetin e Kosovën në BE, në NATO, në OKB dhe jo për ta lënë të izoluar siç disa dëshirojnë. Për deputetin Grainca, unë e thashë kemi dy lloje të masave, e para është masat që me të vërtetë mund t’i bëjmë edhe kemi pasur edhe kohë kur i kemi bërë kur KEK-u e ka bërë edhe marrjen e “Vallaqit”, por ju e dini që janë krijuar tensione dhe mandej kanë ndërhy partnerët ndërkombëtar, prapë u desht t’i japim rrugë dialogut. E dyta siç iu thashë në procesin e dialogut zakonisht proceset ecin kur të dy palët zbatojnë marrëveshjet, unë për vete e kam pasur mjaft të qartë kushtin, nuk ka asosacion pa e marrë Kosova kodin telefonik dhe pa u hequr barrikadat, bile kam pasur shtuar edhe drejtesinë por ju e dini që Kosova e mori kodin telefonik, barrikada nga ura u heq dhe rivitalizimi po zhvillohet, por mandej u bë një mur që bllokoj proceset, u bë një mur ilegal dhe një tren ilegal dhe shumë tensione, fletëarresti ndaj ish -Kryeministrit dhe liderit të AAK-së z. Haradinaj dhe krejt këto elemente krijuan pengesa edhe në dialog. Tani kanë rënë tensionet dhe vizita e përfaqësuesës së lartë të BE-se znj. Mogerini po i shërben ecjes përpara të zbatimit, pra janë dy nivele të kushteve bashkë i bisedojmë dhe bashkë marrim vendim.

Kryetari: Kërkojma nga ministrja dhe kabineti Qeveritar që të vazhdojnë me aktivitetet lidhur me zbatimin e marrëveshjes në mënyrë edhe me energjike, ka kaluar një kohë dhe kjo ka qenë brenga jonë, sidomos kur e kemi diskutuar tani marrëveshjen me operatorin e Shqiperisë, që ajo marrëveshje pa i krye këto punë për të cilat po flasim nuk i siguron të gjitha efektet. Ne e kemi thirrur këtë mbledhje në mënyrë që t’i japim mbështetje Qeverisë, Ministrisë, KOSTT-it dhe të gjitha institucioneve tona që tash e tutje të lëmë të hapur mundësinë, por njëkohësisht në mënyrë shumë të qartë të zhvillojmë një sërë masash me të cilat ne i mbrojmë interesat tona ekonomike dhe kërkojmë zbatimin e marrëveshjes. Edhe ministrja e përmendi mendoj se ne duhet te jemi të durushem, por duhet t’i kemi edhe ato masa që do t’i prezantojmë në bashkëpunim dhe mënyrë shumë të koordinuar, por edhe gjithçka e ka njëfarë kohe kur duhet të zbatohen gjithashtu nuk mund të shkojmë ne në konkluzat marrëveshjet. Ne kemi këtu një dëm ekonomik të cilin duhet ta

sanojmë edhe veprimi në mënyrë të pavarur i KOSTT-it edhe antarësimin e tij në Asoacionin e Rregullatorëve Evropianë dhe e treta duhet të sigurojmë që secili qytetar i Kosovës energjinë që e shpenzon që ta paguajë, në këto tri çështje ne kërkojmë aktivitete dhe masa me të cilat ne do t'i mbronim interesat ekonomike të Kosovës.

Komisioni u pajtua me propozimet e kryetarit dhe do ta njoftojë Kuvendin më konkluzat e tij lidhur më anëtarësimin e KOSTT-it në ENTSO-E.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetari e informoj Komisionin që në mbledhje morën pjesë profesionistët e rinj nga vendet e Ballkanit, si znj. Spahiu nga Shqipëria, z. Josifofski nga Maqedonia, znj. Nesiç nga Serbia, znj. Paloviç nga Mali i Zi dhe znj. Bugorin nga Bosnja dhe Hercegovina. Këta janë profesionit të rinj të cilët kanë ardhur në Ministrinë për Integritet për një intership më një projekt të British Council. I përshëndesim të gjithë dhe i falenderojmë për pjesëmarrje, këta kanë qëlluar në një mbledhje dhe në çështjen që diskutuam, ku shihet se ende në rajonin tonë ka pengesa për të krijuar atmosferën e bashkëpunimit në mes vendeve tona.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa